



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Kumtesë për media

RrGK fton qytetarët të kërkojnë drejtësi për Zejnepen

[#DrejtësiPerZejnepen](#)

Të premten me 4 gusht, në ora 10:00, Rrjeti i Grave të Kosovës fton aktivistë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe qytetarë, në protestën paqësore para Pallatit të Drejtësisë, për të kërkuar dënim maksimal për Nebih Berishën, vrasësin e viktimës së dhunës në familje Zejnepe Berisha.

Pasi që institucionet e drejtësisë nuk po ndërmerrnin masat e duhura, pas [reagimeve të shumta](#), RrGK angazhoi avokaten Fehmije Gashi Bytyqi që të përfaqësonte familjen e Zejnepes. Si rezultat, pas ankesave të bëra nga përfaqësuesja e familjes së Zejnepes, Gjykata e Apelit në Prishtinë ka vendosur që të mbajë një seancë të premten në ora 10:00.

Pas vrasjes së Zejnepës, me urdhër të Gjykatës Themelore të Prizrenit me 12 prill vrasësi i viktimës është dënuar me vetëm 12 vjet burg. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, në nenin 179 mbi Vrasjen e Rëndë thotë se “Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili: ... 1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes”. Duke marrë parasysh rrethanat se si ka ndodhur kjo vrasje, peshën e veprës dhe dhunën sistematike që viktima ka përjetuar, RrGK vazhdon ta konsideroj këtë dënim si jo proporcional me veprën e kryer.

Ju rikujtojmë se në të kaluarën institucionet përgjegjëse janë deklaruar se duhet të ketë zero tolerancë ndaj dhunës në familje, por dënimet e tilla minimale nuk po përçojnë të njëjtin mesazh. Ato po japin mesazhin e gabuar se krimet e tilla makabre nuk do të marrin dënimin e merituar.

Prandaj, RrGK shpreson që Gjykata e Apelit gjatë kësaj seance do të nxerr një aktvendim meritor. RrGK beson që me vendime të drejta, organet e drejtësisë mund të ndikojnë në uljen e dhunës, respektivisht krimin. Dhuna në familje është krim!

RrGK dhe Rrjeti Ballkanik për Gazetari Huluntuose (BIRN) po bashkëpunojnë në monitorimin e institucioneve relevenate lidhur me rastet e dhunës në baza gjinore, duke përfshirë rastet e dhunës në familje. Ky bashkëpunim synon të ngrisë përgjegjësinë institucionale gjatë trajtimit të dhunës në baza gjinore, dhe të rrisë raportimin e këtyre rasteve, duke u siguruar të ketë drejtësi, mbrojtje dhe rehabilitim për rastet e dhunës në baza gjinore.

Eveni në Facebook: [#DrejtësiPerZejnepen](#)